



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 maj 2022
Nr. ref.: KK 85/ 22

Në bazë të paragrafit 2 të nenit 2 (Organizimi i punës së Gjykatës Kushtetuese) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, rregullit 1 (Dispozitat e Përgjithshme) të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2018, si dhe në përputhje me Vendimin nr. KK 249/21 të datës 20 tetor 2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 04/2012 për stazhin e Praktikantëve, Gjykata në seancën administrative të datës 22 mars 2022 aprovon:

RREGULLORE Nr.02/2022
PËR PUNËN PRAKTIKE NË GJYKATËN KUSHTETUESE

I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e statusit, kriterëve dhe procedurave për angazhimin, edukimin profesional, kompensimin material si dhe përcaktimin e kushteve të përgjithshme të kryerjes së punës praktike në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet ndaj zyrtarëve të Gjykatës dhe të angazhuarve për punë praktike në Gjykatë.

Neni 3
Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

Gjykatë – Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës;

Praktikant – personi që ka shtetësinë e Kosovës dhe është i angazhuar në Gjykatë me qëllim të kryerjes së punës praktike për një periudhë të caktuar kohore;

Praktikant ndërkombëtar – personi që ka shtetësinë e një shteti të huaj dhe është i angazhuar në Gjykatë me qëllim të kryerjes së punës praktike për një periudhë të caktuar kohore;

Mbikëqyrës i Praktikantëve – këshilltari kushtetues juridik i caktuar për të mbikëqyrur punën praktike të praktikantëve dhe praktikantëve ndërkombëtarë;

DABNJ – Departamenti i Administratës dhe Burimeve Njerëzore i Gjykatës;

Certifikatë – akt administrativ i lëshuar nga Gjykata me të cilin dëshmohet se praktikanti apo praktikanti ndërkombëtar ka përfunduar punën praktike dhe statusin e praktikantit në Gjykatë dhe ka marrë njohuri themelore për punët në Gjykatë.

Neni 4 Shpallja publike

1. Gjykata shpall konkurs publik për angazhimin e praktikantëve për një kohë të caktuar sipas nevojës, me qëllim të edukimit profesional të tyre në fushën e drejtësisë kushtetuese;
2. Shpallja publike bëhet nga Sekretaria;
3. Kushtet dhe kriteret për përzgjedhje dhe angazhim për punë praktike si dhe kohëzgjatja e punës praktike përcaktohen në shpalljen publike;
4. Gjykata ofron mundësi të barabarta të angazhimit për gjithë kandidatët aplikues.

Neni 5 Kriteret për aplikim për praktikantë

1. Të drejtë aplikimi për pozitën e praktikantit kanë të gjithë kandidatët që:
 - i. janë shtetas të Republikës së Kosovës;
 - ii. kanë zotësi të plotë për të vepruar;
 - iii. zotërojnë njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë si dhe kanë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze;
 - iv. kanë diplomuar në fakultetin juridik në njërin nga universitetet në Kosovë, kanë diplomë të fakultetit juridik të nostrifikuar në Kosovë ose janë në vitin e fundit të studimeve në fakultetin juridik; dhe
 - v. demonstrojnë shkathtësi solide kompjuterike;
2. Kandidatët duhet të paraqesin aplikacionin përkatës të Gjykatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacioni përkatës për përgatitjen shkollore.

Neni 6

Përzgjedhja e praktikantëve

1. Kandidatët i nënshtrohen vlerësimit paraprak të njohurive të tyre profesionale përmes testit me shkrim dhe intervistës me gojë;
2. Vlerësimi i kandidatëve bëhet nga një komision profesional i përbërë nga Këshilltari i Parë si kryesues dhe katër (4) anëtarë tjerë të caktuar me një vendim të veçantë të Sekretarit të Përgjithshëm, kurse vendimi përfundimtar për angazhimin e praktikantëve merret nga Gjykata në seancë administrative;
3. Pas përzgjedhjes sipas parimit të meritës, praktikantët do të angazhohen në Gjykatë në përputhje me Ligjin nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2018, dhe me këtë rregullore, si dhe do të kenë statusin e praktikantit në Gjykatë.

Neni 7

Periudha e angazhimit të praktikantëve

1. Praktikantët në Gjykatë do të angazhohen për një periudhë kohore deri në një (1) vit;
2. Në varësi nga mjetet e disponueshme financiare dhe hapësira fizike për akomodim të praktikantëve, në të njëjtën periudhë kohore mund të angazhohen më së shumti dhjetë (10) praktikantë;
3. Praktikantët e përzgjedhur do të nënshkruajnë kontratën e punës për periudhë të caktuar kohore, së bashku me Deklaratën e Konfidencialitetit.

Neni 8

Praktikantët ndërkombëtarë

1. Kandidatët për pozitën e praktikantit ndërkombëtar duhet të plotësojnë këto kritere:
 - i. kanë shtetësinë e një shteti të huaj;
 - ii. kanë zotësi të plotë për të vepruar;
 - iii. kanë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze;
 - iv. kanë diplomuar në fakultetin juridik, ose janë në vitin e fundit të studimeve; dhe
 - v. demonstrojnë shkathtësi solide kompjuterike;
2. Praktikantët ndërkombëtarë do të kenë statusin e vullnetarit në Gjykatë, pa të drejtë kompensimi nga ana e Gjykatës;
3. Kandidatët për praktikantë ndërkombëtarë mund të angazhohen në Gjykatë në njërin nga mënyrat si në vijim:

- i. duke dërguar një kërkesë personale të arsyetuar për angazhim në Gjykatë; apo
 - ii. me rekomandim të institucioneve ndërkombëtare, rekomandim i cili duhet t'i dërgohet Gjykatës drejtpërdrejt nga institucioni;
4. Së bashku me kërkesën personale drejtuar Gjykatës sipas paragrafit 8.3.i, kandidatët për praktikant ndërkombëtarë duhet të paraqesin një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjen shkollore. Kurse në rastet kur Gjykata pranon rekomandime nga institucionet ndërkombëtare sipas paragrafit 8.3.ii, Gjykata mund të kërkojë edhe nga këta kandidatë të rekomanduar që të dërgojnë dokumentet e lartpërmendura;
 5. Kërkesa personale për angazhim si praktikant ndërkombëtar sipas paragrafit 8.3.i do të vlerësohet nga një komision profesional i përbërë nga Këshilltari i Parë si kryesues dhe katër (4) anëtarë tjerë të caktuar me një vendim të veçantë të Sekretarit të Përgjithshëm, kurse vendimi përfundimtar për angazhimin e praktikantit ndërkombëtar merret nga Gjykata në seancë administrative;
 6. Rekomandimi i institucionit ndërkombëtar për angazhim të praktikantit ndërkombëtar sipas paragrafit 8.3.ii do të vlerësohet nga Gjykata në seancë administrative, si dhe vendimi përfundimtar për angazhimin e praktikantit ndërkombëtar do të merret nga Gjykata në seancë administrative;
 7. Kushtet e përgjithshme të angazhimit në Gjykatë të praktikantëve ndërkombëtarë si detyrat që mund t'u përcaktohen dhe afati i lejuar për qëndrim në Gjykatë përcaktohen në vendimin për angazhimin e praktikantit ndërkombëtar;
 8. Mbikëqyrësi i praktikantëve i caktuar sipas nenit 13.2 të kësaj rregullore mbikëqyr punën e praktikantëve ndërkombëtarë si dhe bën shpërndarjen e detyrave.

Neni 9 Hulumtuesi shkencor

1. Kryetari i Gjykatës, në konsultim me Gjyqtarët e Gjykatës, mund të miratojë kërkesat për qasje në Bibliotekën e Gjykatës dhe/apo platformat kërkimore online të personave të cilët nuk janë zyrtarë të Gjykatës dhe të cilët kërkojnë qasje në këto të fundit për qëllime hulumtimi shkencor nëpërmjet dërgimit të një kërkesë për qasje të arsyetuar mirë. Qasja e hulumtuesve shkencor në Bibliotekën e Gjykatës dhe/apo platformat kërkimore online lejohet në bazë të nenit 10 të Rregullores Nr. 02/2022 për Organizimin dhe Funksionimin e Bibliotekës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
2. Në vendimin e Kryetarit të Gjykatës për miratimin e kërkesës për qasje në Bibliotekë të hulumtuesit shkencor duhet të përcaktohet, ndër informacione tjera të rëndësishme, kohëzgjatja dhe kushtet e caktuara të qasjes. Këta hulumtues mund të jenë, por nuk kufizohen në, zyrtarë të institucioneve publike në Kosovë, studiues, juristë, profesorë, studentë dhe përfaqësues të organizatave jo-qeveritare;

3. Personat të cilëve u lejohet qasja në bazë të paragrafit 1 të këtij neni duhet të nënshkruajnë Deklaratën e Konfidencialitetit, si dhe duhet të veprojnë në pajtueshmëri me, ndër të tjera, Rregulloren Nr. 02/2022 për Organizimin dhe Funksionimin e Bibliotekës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës si dhe me rregullat tjera të aplikueshme.

II – ORARI I PUNËS DHE KOMPENSIMI MATERIAL

Neni 10

Orari i punës dhe vijueshmëria

1. Praktikantët e përzgjedhur punën praktike në Gjykatë e fillojnë në ditën e nënshkrimit të kontratës;
2. Orari i punës së praktikantit në Gjykatë është orari i rregullt i të punësuarve në Gjykatë;
3. Orari i qëndrimit në Gjykatë i praktikantëve ndërkombëtarë përcaktohet në vendimin e Gjykatës për lejimin e angazhimit.

Neni 11

Kompensimi material

1. Shuma e kompensimit material të praktikantëve do të jetë ekuivalente me pagën minimale në Republikës e Kosovës në vitin e angazhimit të praktikantit;
2. Mjetet financiare për kompensim të praktikantëve sigurohen nga buxheti i Gjykatës apo nga fondet e fituara nga donatorët ndërkombëtarë;
3. Praktikantët ndërkombëtarë nuk kompensohen materialisht për kohën e qëndrimit në Gjykatë.

III – PROGRAMI I EDUKIMIT DHE MBIKËQYRJA

Neni 12

Vendosja e Praktikantëve

Puna praktike në Gjykatë do zhvillohet sipas nevojës brenda Njesisë Ligjore apo në departamentet tjera të Gjykatës.

Neni 13 **Përshkrimi i detyrave të punës**

1. Detyrat kryesore të punës së praktikantit janë si në vijim:
 - i. angazhohet në punën e këshilltarëve kushtetues juridik dhe të gjyqtarëve;
 - ii. mbledh dhe studion literaturë përkatëse ligjore, informacione dhe dokumente sipas kërkesës nga këshilltarët ligjor dhe nga gjyqtarët;
 - iii. përgatit analiza krahasuese nën udhëheqjen e këshilltarëve kushtetues juridik;
 - iv. hulumton praktikat dhe vendimet e gjykatave tjera kushtetuese dhe ato të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
 - v. mirëmban dhe përditëson shënimet përkatëse të databazave të Gjykatës;
 - vi. përkujdeset për fajllimin e dokumentacionit përkatës, skenimit, fotokopjimit të materialeve të nevojshme sipas kërkesës; dhe
 - vii. kryen punë të tjera profesionale sipas kërkesës së Kryetarit, Këshilltarit të Parë, Gjyqtarëve apo Mbikëqyrësit të praktikantëve;
2. Këshilltari i Parë cakton mbikëqyrësin e praktikantëve si dhe mënyrën e shpërndarjes së detyrave konkrete për secilin praktikant;
3. Kryetari i Gjykatës apo secili nga Gjyqtarët e Gjykatës mund të kërkojë që praktikantë të caktuar të angazhohen në zyrën e tij/saj për asistencë teknike-profesionale apo për angazhim në detyra të caktuara;
4. Për kërkesën në paragrafin 13.3 njoftohet Këshilltari i Parë.

Neni 14 **Kushtet e punës**

1. Para se të fillojnë punën praktike në Gjykatë, praktikantët dhe praktikantët ndërkombëtarë mbajnë trajnimin fillestar orientues me qëllim të njoftimit me punën e përgjithshme të Gjykatës;
2. Gjykata përkujdeset që praktikantëve dhe praktikantëve ndërkombëtarë t'iu sigurojë kushte të mira pune dhe pajisje të nevojshme për kryerjen e punës praktike;
3. Praktikantët dhe praktikantët ndërkombëtarë duhet të kujdesen me mirësjellje për pajisjet e Gjykatës të cilat mund t'i kenë në zotërim të përkohshëm dhe me pajisjet që janë në përdorim të përgjithshëm.

Neni 15 **Konfidencialiteti**

1. Praktikantëve dhe praktikantëve ndërkombëtarë u dorëzohet Kodi i Etikës së Gjykatës dhe njoftohen se janë të detyruar ta respektojnë plotësisht;

2. Praktikantët dhe praktikantët ndërkombëtarë nënshkruajnë **DEKLARATËN E KONFIDENCIALITETIT** dhe obligohen ndër të tjera që të mos transmetojnë tek asnjë palë e tretë informacionet konfidenciale që marrin gjatë punës apo qëndrimit në Gjykatë;
3. Praktikantëve dhe praktikantëve ndërkombëtarë iu ndalohe të japin çfarëdo informacioni apo të bëjnë deklarata publike lidhur me punën e Gjykatës tek palët e treta, përfshirë por duke mos u kufizuar në media, rrjete sociale, persona publikë dhe persona privatë;
4. Detyrimet e cekura më lart vlejnë për praktikantët dhe praktikantët ndërkombëtarë edhe pasi që të kenë përfunduar punën praktike apo qëndrimin në Gjykatë;
5. Deklarata e konfidencialitetit nga neni 15.2 është Shtocja I e kësaj Rregullore dhe është pjesë integrale e saj;
6. Shkelja e Kodit të Etikës së Gjykatës dhe rregullave për ruajtjen e konfidencialitetit përbën shkak të ndërprerjes së menjëhershme të punës praktike në Gjykatë.

Neni 16 **Pjesëmarrja në aktivitete**

1. Praktikantët dhe praktikantët ndërkombëtarë nuk marrin pjesë në seanca shqyrtuese, forume, mbledhje apo aktivitete tjera profesionale të Gjykatës, përveç nëse pranojnë ftesë paraprake në raste të veçanta;
2. Praktikantët dhe praktikantët ndërkombëtarë mund të marrin pjesë në mbledhjet e rregullta të Njesisë Ligjore me ftesë të Këshilltarit të Parë.

IV – EVIDENCA

Neni 17 **Vijueshmëria dhe pushimet**

1. Praktikanti ka të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë nga marrëdhënia e punës që burojnë nga Rregullorja Nr. 02/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, dhe rregullat tjera të aplikueshme;
2. Praktikantët fitojnë të drejtën për pushim vjetor pas gjashtë (6) muajsh të punës së pandërprerë, nga një ditë e gjysmë (1.5) të pushimit për çdo muaj kalendarik të kaluar në punë;

3. Kërkesa për pushim i drejtohet mbikëqyrësit të praktikantëve dhe Këshilltarit të Parë, dhe dorëzohet për evidentim në DABNJ;
4. DABNJ pajis praktikantët dhe praktikantët ndërkombëtarë me kartelë identifikuese të Gjykatës së bashku me kartelën për evidentim të hyrje-daljeve në Gjykatë;
5. Secili praktikant dhe praktikant ndërkombëtar është i obliguar të regjistrohet në aparatin elektronik për evidentimin e hyrje-daljeve së të punësuarve në Gjykatë, të vendosur në hyrje të Gjykatës;
6. Për secilin praktikant dhe praktikant ndërkombëtar përgatitet dhe bëhet dosja personale me shënime të plota personale dhe dëshmitë për kualifikimet profesionale.

Neni 18 Raportimi dhe vlerësimi

1. Praktikantët dhe praktikantët ndërkombëtarë për çdo javë dorëzojnë raportet e tyre të punës tek mbikëqyrësi i praktikantëve;
2. Para kalimit të afatit kohor për të cilin janë pranuar në Gjykatë, praktikantët dhe praktikantët ndërkombëtarë i nënshtrohen vlerësimit të njohurive të fituara gjatë punës praktike;
3. Vlerësimi i punës praktike bëhet nga mbikëqyrësi i praktikantëve në bazë të raporteve të dorëzuara, vijueshmërisë dhe mirësjelljes së treguar gjatë periudhës së punës praktike, si dhe nënshkruhet nga Këshilltari i Parë;
4. Pas përfundimit të periudhës vlerësuese, mbikëqyrësi i praktikantëve rekomandon DABNJ-në për përgatitjen e certifikatës për kryerjen e suksesshme të punës praktike në Gjykatën Kushtetuese.

IV – DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 19 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet Rregullorja nr. 04/2012 për Stazhin e Praktikantit në Gjykatën Kushtetuese.

Neni 20
Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, pas aprovimit paraprak në seancën administrative.

Prishtinë, 4 maj 2022

Kryetare e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

